



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Ministarstvo Rada i Socialne Zaštite-Ministry of
Labour and Social Ėelfare*

Në përputhje me nenin 1, paragrafi 1.3, pika (d) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh dispozitat e nenit 5 paragrafi 5.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë,

Me qëllim të krijimit dhe vendosjes së rregullave për regjistrimin e organizatave të punëtorëve në përputhje me dispozitat e konventave ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë sindikale;

Nxjerr:

UDHZIM ADMINISTRATIV NR.10/2008 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 05/2008
PËR
RREGULLIMIN DHE PERCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PER
REGJISTRIMIN E SINDIKATAVE

Neni 1

1. Paragrafi 3 i nenit 3, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin vijues:

1.1. Dokumentin për emërtimin, selinë dhe llogon e sindikatës.

2. Neni 3, i shtohet edhe një paragrafë i ri me numër rendor 7 dhe ka këtë përmbajtje;

2.1. Emërtimi i sindikatës i cili nuk duhet të jetë i njëjtë me sindikatat e regjistruara në MPMS-së.

Neni 2

1. Paragrafi 2 pika 1 e nenit 5, ndryshohet dhe plotësohet si në tekstin vijues:

1.1. Procesverbalin e organit të sindikatës në të cilin pjesëmarrës ishin se paku dy të tretat e anëtarëve të cilët kanë marre pjese në kuvendin e parë, para se kjo të jetë regjistruar në MPMS.

Neni 3

1. Paragrafi 1 i nenit 7, të pasuesi i fundit, (Departamentin Ligjor të MPMS-së), fshihet dhe zëvendësohet me “ Zyrën e Sekretarisë Teknike të Këshillit Ekonomik-Social “.

2. Paragrafi 3 i nenit 7, fshihet dhe zëvendësohet me paragraf të ri si në tekstin vijues:

2.1. Organi përgjegjës i MPMS-së, kur vlerëson se ka mangësi në dokumentacion, kërkon nga përfaqësuesi i organizatës sindikale në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës të ofroj informata tjerë që mund të jetë e arsyeshme me qëllim që kushtet për regjistrim, të përcaktuara me këtë Udhëzim, të përmbushen.

3. Neni 7 i shtohen edhe tre (3) paragrafë të ri me numër rendor 7, 8, dhe 9 si në tekstin vijues:

3.1. Nëse Ministria nuk ka marr vendim sipas paragrafit 2, 3 dhe 4 të këtij nenit, atëherë sindikata e interesuar mund të konsideroj se është regjistruar sipas rregullave të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ

3.2. Ministria do të publikojë në Gazetën Zyrtare, vendimin (njoftimin) për regjistrim të sindikatës.

3.3. Ministria do të publikon në Gazetën Zyrtare listën e sindikatave të regjistruara në MPMS .

Neni 4

1. Pas nenit 9 shtohet neni i ri me numër rendor 10 me dy paragrafë si në tekstin vijues:

1.1. Anëtari i një organizate sindikale nuk mund të jetë edhe anëtar i një organizate sindikale tjetër.

1.2. Pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ, të gjitha sindikatat e regjistruara në MPMS-së gjer më tani, duhet të aplikojnë për ri-regjistrim më së largu në afatin prej një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 5

1. Neni 10 bëhet 11, dhe neni 11 bëhet 12.

Neni 6 **Hyrja në fuqi**

Ky Udhëzimi Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Punë dhe Mirëqenies Sociale.

Prishtinë, Dhjetor 2008

Ministri i MPMS-së

Nenad Rašić